



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. _____, Datë _____.____.2016

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008 “PËR
KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 101 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pika 6 e nenit 101, ndryshon:

“6. Të dhënat që ruhen në këta skedarë duhet t’u vihen në dispozicion subjekteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, sipas kërkesës së tyre edhe në formë elektronike:

- a) menjëherë por jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës për:
 - i) identifikimin e pajtimtarit kur dihet numri apo adresa e IP;
 - ii) identifikimin e pajisjeve apo adresave të IP për një pajtimtar të dhënë;
 - iii) identifikimin e vendndodhjes së një pajisje fundore apo IP;

b) brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës për të dhënat e tjera të ruajtura në skedarët e parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni”.

Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Vonesa e pajustificuar për vënien në dispozicion të të dhënave të kërkuara sipas pikës 6 të këtij neni, kur ka dëmtuar hetimin përbën vepër penale”.

Neni 2

Pas nenit 101/1, shtohet neni 101/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 101/2

Vënia në dispozicion e të dhënave për qëllime të ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare

1. Me qëllim ruajtjen e sigurisë publike dhe kombëtare, parandalimin e krimeve të rënda dhe akteve terroriste, sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike detyrohen të vënë në dispozicion menjëherë, në formë elektronike për Prokurorinë, Shërbimet Informative dhe Policinë e Shtetit të dhënat që ruhen në skedarë për:

- a) identifikimin e pajtimtarit kur dihet numri apo adresa e IP;
- b) identifikimin e pajisjeve apo adresave të IP për një pajtimtar të dhënë;
- c) identifikimin e vendndodhjes së një pajisje fundore apo IP;

2. Të dhënat u vihen në dispozicion personave të autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesit e Shërbimeve Informative, Drejtori i Policisë së Shtetit nëpërmjet dhënies së aksesit të drejtpërdrejtë në skedarë apo pjesë të tyre, ose ngritjes së platformave elektronike. Kjo përcaktohet në marrëveshje mes palëve brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose nga fillimi i operimit për sipërmarrësit që hyjnë rishtas në treg.

3. Kërkesat dhe të dhënat e shkëmbyera nga Prokuroria, Shërbimet Informative, Policia e Shtetit dhe sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar”.

4. Vonesa e pajustificuar në dhënien e informacionit, kur ka dëmtuar sigurinë publike dhe kombëtare përbën vepër penale”.

Neni 3

Pika 1, paragrafi I, nënpika 20 e nenit 137 ndryshon:

“20. Nuk përmbush detyrimet për ruajtjen dhe vënien në dispozicion të të dhënave, sipas neneve 101, 101/1 dhe 101/2 të këtij ligji”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META